

VENDIM
Nr. 402, datë 4.7.2018

PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA POLIÇAN, TË PRONËS NR. 1069, ME EMËRTIM “KOMBINATI MEKANIK ZONA B”, ME VENDNDODHJE NË POLIÇAN, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR, DHE NË VENDIMIN NR. 207, DATË 9.3.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË POLIÇAN, TË QARKUT TË BERATIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Poliçan, të pronës nr. 1069, me emërtim “Kombinati Mekanik Zona B”, me vendndodhje në Poliçan, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi, për ta përdorur për vendosjen e ndërmarrjes së shërbimit pyjor, për magazinimin dhe përpunimin e lëndës drusore, të materialeve të ndërtimit, instalimin e makinerive dhe pajisjeve teknologjike të ndërmarrjeve në varësi të Bashkisë Poliçan, për zbatimin e projekteve në funksion të zhvillimit social-ekonomik të zonës, si dhe për realizimin e funksioneve ekonomike dhe të funksioneve të tjera sipas ligjit.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të hiqet prona nr. 1069, me emërtim “Kombinati Mekanik Zona B”, me vendndodhje në Poliçan, dhe të shtohet në listën e inventarit të pronave paluajtshme që i kanë kaluar në pronësi ose në përdorim Bashkisë Poliçan, miratuar me vendimin nr. 207, datë 9.3.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. Bashkisë Poliçan i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, kryetari i Bashkisë Poliçan, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PLAN RILEVIMI
Prona Nr. 1069 "Kombinati Mekanik Zona B" POLIÇAN


MIRATOHET
 Drejtori i Kombinatit Mekanik Poliçan
ERJON ZYLYFTARI

Hartoi
 Topograf Ramiz HAXHUU
 Ing. Ertan MACI
 Mars 2018

DREJTORI I FIGJË
 N/Kol. Ark. **FERDI HYRAJ**

IDENTIFIKIMI I PASURISE

Zona Kadastrale 3019
 Nr. Pasurise Vol. 1^q
 Indeksi i Hartes K-34-125-(35-B,D)
 Shkalla 1: 2500
 Adresa e pasurise, Poliçan
 Q/F Poliçan
 Pronari :
 Ministria e Mbrojtjes, Kombinati Mekanik Poliçan



Sip. nën objekte
 objekti nr. 201 = 1491.0m²
 objekti nr. 202 = 819.4m²
 objekti nr. 203 = 461.26m²
 objekti nr. 203/1 = 144m²
 objekti nr. 204 = 340.5m²
 objekti nr. 204/2 = 102m²
 objekti nr. 205 = 359.12m²
 objekti nr. 208 = 22m²
 objekti nr. 208/1 = 73.45m²
 objekti nr. 211 = 544.58m²
 objekti nr. 211 = 132m²
 objekti nr. 220 = 60.75m²
 objekti nr. 221 = 126m²
 objekti nr. 223 = 22.32m²
 objekti nr. 250 = 44m²
 objekti nr. 252 = 42.89m²
 objekti nr. 253 = 185.88m²
 objekti nr. 256/1 = 191.76m²
 objekti nr. 259 = 9m²
 objekti nr. 259/1 = 83.8m²
 objekti nr. 201/2 = 116.25m²
 objekti nr. 206 = 108m²
 objekti nr. 209 = 44.2m²
 objekti nr. 222 = 16m²
 Sip. përgj. nën objekt = 5 540.8m²

SHPIEGUESË
 Sip. e përgjithëshme = 100 000 m²
 Sip. nën objekte = 5 540.8m²
 — Kufiri i pronës

Shënim: Ky Plan Rilevimi u hartua në zbatim të shkresës të Drejtorit të Kombinatit Mekanik Poliçan nr.689/1, datë 18.12.2017 dhe 224 datë 13.3.2018 sipas matjeve të kryera në terren me GPS R8 me dt.26.12.2017 në prani të Drejtorit të Kombinatit Mekanik dhe përfaqësuesit të bashkisë Poliçan. Kufiri i pronës është pjesërisht i materializuar në terren me bandjera të rrethimit të dëmtuara.